

KONTRATE PER DHURIMIN E KUOTES

Sot, me 28/05/2019, lidhet kjo Kontrate per Dhurimin e Kuotes midis paleve te meposhtme:

- SAMIH EL CHADLI, shtetas palestinez, lindur me 12/11/1954, ne El Bass Tyr, mbajtes i dokumentit te udhetimit nr. PR0129790;
- HUDA CHADLI, shtetase palestineze, lindur me 18/05/1989, ne Abu Dhabi, mbajtese e dokumentit te udhetimit nr. 526417;

ne cilesine e Ortakeve te shoqerise "CHADLI" SHPK, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar sipas ligjeve te Shqiperise, regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me numer NUIS L82218032S dhe seli te ndodhur tek Rruga "Myslym Shyri", pallati Swaroski, kati 4, zyra 26, Tirana, Albania

(në vijim referuar te dy si "Dhuruesit")

Dhe

- RABIE RA'ED MOHAMMAD AL JOHARI, shtetas jordanез, lindur më 12/04/1990, në Amman, mbajtës i pasaportes me nr. O227530;

(ne vijim referuar si "Perfituesi")

bashkërisht të referuar si "Palët";

MEQENESE:

1. Dhuruesit jane pronare te ligjshëm te 2 kuotave që përfaqësojne secila nga 50% të kapitalit themeltar të "CHADLI" SHPK, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar sipas ligjeve te Shqiperise, regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me numer NUIS L82218032S (ne vijim "Shoqeria");
2. Dhuruesit i ofrojne Perfituesit 1 kuote e cila perfaqeson 34% te kapitalit themeltar te Shoqerise, (me poshte referuar si "Kuota");
3. Perfituesi e pranon kete dhurim;

Palet lidhin kete Kontrate per Dhurimin e Kuotes (më poshte referuar si "Kontrata"), sipas termave dhe kushteve të mëposhtme:

Neni 1 Objekti i Kontrates

Sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontrate, me ane te kesaj Kontrate Dhuruesit bien dakord për t'i dhuruar Perfituesit Kuoten bashke me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kuota.

1

Aplleenti
Melisa Remanti

Palet pranojnë se si rezultat i ketij dhurimi, secili prej tyre ne vijim do te kete nga 1 kuote e cila perfaqeson kapitalin si me poshte:

- 1- **Samih El Chadli** – zoterues i 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 33% te kapitalit themeltar te Shoqerise;
- 2- **Huda Chadli** – zoteruese e 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 33% te kapitalit themeltar te Shoqerise;
- 3- **Rabie Ra'ed Mōhammad Al Johari** - zoterues i 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 34% te kapitalit themeltar te Shoqerise;

Neni 2 Transferimi i Kuotes

Transferimi i Kuotes dhe regjistrimi i kesaj Kontrate ne Qendren Kombetare te Biznesit do te kryhen ne perputhje me ligjet e aplikueshme.

Neni 3 Garancite e Dhuruesit

Dhuruesit garantojne se:

- 3.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100,000 Lekë.
- 3.2 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate, Dhuruesit jane te vetmit Ortake te Shoqerise.
- 3.3 Dhuruesit jane pronare te ligjshem te Kuotes, e cila dhurohet e lire nga cdo pengese apo kufizim, kolateral apo barre te cdo lloji.
- 3.4 Kuota e dhuruar sipas kesaj Kontrate perfaqeson 34% te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Neni 4 Garancite e Perfituesit

Perfituesi garanton, deklaron dhe merr persiper kundrejt Dhuruesve sa me poshte:

Perfituesi merr persiper te gjitha detyrimet e tashme dhe te ardhshme, pa asnje kufizim, ne lidhje me Kuoten, si ortak i 34% te kapitalit themeltar te Shoqerise dhe nepermjet kesaj Kontrate heq dorë nga cdo e drejte per t'i kunderdrejtuar ndonje pretendim Dhuruesve ne te ardhmen ne lidhje me detyrime te pashlyera ose pretendime te paleve te treta ne lidhje me Kuoten ose me pergjegjesine e tij si ortak i 34% te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Neni 5 Pjesshmeria

2

Melisa Pinarfi

Nëse ndonjë nga pjeset e kësaj Kontrate do të behet e pazbatueshme për çfarëdo arsye, pjesa e mbetur e kësaj Kontrate do të vazhdojë të jete në fuqi me efekt të plotë. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme ose e pazbatueshme nga çdo gjykatë kompetente, dhe në qoftë se kufizimi i kesaj dispozite do ta bente te vlefshme, atëherë dispozita do te konsiderohet e formuluar sipas kufizimit.

Kjo Kontrate përbën te gjithë marrëveshjen midis Palëve dhe zëvendëson çdo marreveshje paraprake ose garanci të çdo lloji para datës së kësaj Kontrate.

Kjo Kontrate mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga të dy Dhuruesit dhe Perfituesi.

Neni 6 Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

Kjo Kontrate do t'i nenshtrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Nëse lind një mosmarrëveshje, Palët do të përpiqen për të zgjidhur atë me diskutime dhe negociata para se të fillojnë procedurat ligjore. Gjykatat shqiptare do të kenë juridiksion ekskluziv mbi çdo mosmarrëveshje.

Neni 7 Te ndryshme


Kjo Kontrate nënshkruhet në 3 kopje të barabarta në gjuhën Angleze dhe gjuhën Shqipe me të njëjtën vlerë. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dy versioneve, versioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

Per Dhuruesit:

SAMIH ELCHADLL



Huda malli



Per Perfituesin:

RABIE RAGO ALI SOWARI



Melisa Panarit
